# DËSHMI ARKIVI

**A-455427**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Debati për pagat/ Magjistratët refuzojnë ftesën e Ramës: Do t'i drejtohemi Gjykatës Kushtetuese |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/18/debati-per-pagat-magjistratet-refuzojne-ftesen-e-rames-do-ti-drejtohemi-gjykates-kushtetuese/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 14:04:02 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 17 shtator 2026, 22:00:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 17 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 17 shtator 2026, 22:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 2632434f3ff80949e64030860a1aa94cd96673fe841b4be109ec496dad86abd0 |
| TEKSTI | 20c26333d09d1c61ccf7f776774400804df9542ab28480856c0e106a5ae4d45d |
| PAMJA | 22ee9f498bb2040733b8a7c119e7be966c54db6f05698af7d42ca32153270f51 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 050c4491830e7fcb3f4ef9a953aabbc848dc9fe1e09b8e265ed0d9f634d26bd8 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 9c628a07075feceb8104ab280f983adfb76a5f01a86c5eb5ef058772798de17b |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/050c4491830e7fcb3f4ef9a953aabbc848dc9fe1e09b8e265ed0d9f634d26bd8`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Debati për pagat/ Magjistratët refuzojnë ftesën e Ramës: Do t'i drejtohemi Gjykatës Kushtetuese

Aktualitet

Publikuar: 18/09/2026



Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, Shoqata e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë dhe Forumi i Grave Gjyqtare të Shqipërisë kanë reaguar kundër procedurës së ndjekur për miratimin e ndryshimeve në ligjin për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në një reagim të përbashkët, shoqatat e magjistratëve kanë refuzuar **ftesën e Ramës**për bisedë, ndërsa deklarojnë se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit, shfuqizimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe shqyrtimin e çështjes me përparësi.

Sipas tyre, procedura parlamentare për miratimin e projektligjit është shoqëruar me shkelje të kërkesave kushtetuese dhe përmes këtij ligji, cenohet jo vetëm statusi financiar i magjistratëve, por edhe vetë themelet e shtetit të së drejtës.

*"Në këtë kuadër, informojmë opinionin publik se, me të njëjtën urgjencë me të cilën ky projektligj u shqyrtua, u miratua dhe u dekretua, do t'i drejtohemi Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit, shfuqizimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe shqyrtimin e çështjes me përparësi. Kjo kërkesë bëhet e domosdoshme pasi, përmes këtij ligji, cenohet jo vetëm statusi financiar i magjistratëve, i cili është i lidhur ngushtësisht me garantimin e pavarësisë së tyre, por edhe vetë themelet e shtetit të së drejtës, për shkak të mosrespektimit të hapur të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese",*- thuhet ndër të tjera në njoftim.

Me te lexuarat


Kush është Behajdin Allaqi, njeriu që Haga vendosi në qendër të dënimit të Thaçit dhe pikëpyetjet...


Çoi padashje një video pornografike në një bisedë me shoqet, si u zbulua abuzimi i 12-vjeçares


Furnizoi Millosheviçin me naftë/ Shehu kërkon llogari për gjenocidin serb, Haga [illegible] akuzat e...


Biznesmeni Yzedin Bozhaj kapet duke vjedhur paratë publike në bashkëpunim me rrjetin e supervizor...


Gjyqtarja Enerjeta Shehaj skemë korrupsioni me burrin avokat që u shkarkua nga Vetingu me kërkesë...

**Reagimi i plotë:**

*Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, Shoqata e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë dhe Forumi i Grave Gjyqtare të Shqipërisë shprehin vendosmërinë e tyre për të vijuar ndjekjen e procesit kushtetues lidhur me pagat e magjistratëve.*

*Me keqardhje kemi ndjekur procedurën parlamentare për miratimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'". Që në fillim, kjo procedurë është karakterizuar, në vlerësimin tonë, nga shkelje të kërkesave kushtetuese, duke nisur nga miratimi i projektligjit përtej afatit kushtetues, mungesa e një analize financiare nga Këshilli i Ministrave, mungesa e konsultimit efektiv dhe dëgjimi tërësisht formal i grupeve të interesit dhe, në fund, hyrja e menjëhershme në fuqi e ligjit.*

*Shoqatat tona mbeten të palëkundura në qëndrimin e tyre për rivendosjen e të drejtave kushtetuese të magjistratëve, të cilat janë cenuar haptazi nga ligji i miratuar në orët e mesnatës. Në këtë kuadër, informojmë opinionin publik se, me të njëjtën urgjencë me të cilën ky projektligj u shqyrtua, u miratua dhe u dekretua, do t'i drejtohemi Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit, shfuqizimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe shqyrtimin e çështjes me përparësi.*

*Kjo kërkesë bëhet e domosdoshme pasi, përmes këtij ligji, cenohet jo vetëm statusi financiar i magjistratëve, i cili është i lidhur ngushtësisht me garantimin e pavarësisë së tyre, por edhe vetë themelet e shtetit të së drejtës, për shkak të mosrespektimit të hapur të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese.*

*Shoqatat tona shprehin bindjen e plotë në integritetin e procesit kushtetues dhe besimin se Gjykata Kushtetuese do të rivendosë standardet kushtetuese të cenuara. Kemi besimin e plotë se do të jetë pikërisht procesi kushtetues ai që do të sqarojë çështjet e ngritura dhe do të hedhë poshtë përpjekjet për të diskredituar magjistratët dhe kërkesat e tyre legjitime.*

*Theksojmë edhe një herë se kjo çështje nuk ka të bëjë me interesa financiare, siç është tentuar, në mënyrë të shtrembëruar, t'i paraqitet opinionit publik gjatë gjithë këtij procesi. Ajo lidhet me respektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, garantimin e pavarësisë së organeve të drejtësisë dhe mbrojtjen e themeleve të shtetit të së drejtës.*

*Për mbrojtjen e këtyre parimeve dhe vlerave kushtetuese, shoqatat tona mbeten të palëkundura dhe do të përdorin çdo mjet ligjor që Kushtetuta dhe ligji u vënë në dispozicion.*

TAG: Debati për pagat | ftesën e ramës | magjistratët refuzojnë

## Të ngjashme



**“Nuk mund ta lija jetim” – Pse nuk u bë kurrë baba? Rrëfehet Spartak Ngjela**

**Aksidenti tragjik në Athinë/ Këta janë tre të rinjtë nga Fieri që humbën jetën**



**Spartak Ngjela zbulon ‘kurën’ e xhelozisë: Lëre të dashurën të shkojë me dikë tjetër**

## Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë

KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË
KRYESORE POLITIKË EKONOMI
ANALIZË RAJON KULTURË SPORT

Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

Privacy Policy | Cookies

Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.